

“Këngët e Milosaos” - De Rada

Ish e diela mesnatë
e i biri i Zonjës Madhe
ngjitej tek e bukura
të m’i lypë¹ një pikë ujë,
se ish etit² djegur.
Vetëm e gjeti te vatra,
që më plekëste gërshetin³.
Ata duheshin e s’e thoshin.
Vajza, me buzën më gaz:
- Ç’ke që po ikën si era?
- Më presin në roliet⁴.
- Dy mollë të ardhura,
qëndro se t’i ruajta.
Me një dorë ngritur
mbante mbi veshin e bardhë
leshtë⁵ e saj të shpleksur,
kalli tjetërën te gjiri,
e më hoqi mollëzët,
më ia vu në dorët,
në çeret e ndezur.
Thomni ju, të dashurit,
m’ëmbël ë’ të puthurit⁶

¹ *lypë*: kërkohë

² *etit*: etja

³ *plekëste gërshetin*: thurte gërshetin

⁴ *roliet*: lojë e moçme arbëreshe për burrat

⁵ *leshtë*: flokët

⁶ *m’ëmbël ë’ të puthurit*: nëse është aq i ëmbël të puthurit